

RAPORTI I NDËRMJETËM
15 maj – 3 qershor 2013
7 qershor 2013

I. PËRMBLEDHJE

- Zgjedhjet Parlamentare do të zhvillohen më 23 Qershor. Zgjedhjet konsiderohen si një test i rëndësishëm për aspiratat e Shqipërisë drejt aderimit në Bashkimin Evropian.
- Zgjedhjet do të zhvillohen me një sistem rajonal proporcional sipas të cilit 140 deputetët e Kuvendit do të zgjidhen në 12 zona zgjedhore shumë-emërore. Parlamenti shpërndau mandatet për çdo zonë zgjedhore duke u bazuar në statistikat e papërditësuara të popullsisë, pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja) nuk arriti t'i miratojë. Gjykata Kushtetuese refuzoi juridiksionin në lidhje me ankimin e paraqitur për këtë çështje.
- Zgjedhjet Parlamentare rregullohen nga një kuadër i plotë ligjor, i cili ofron një bazë të shëndoshë ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, nëse zbatohet dhe respektohet plotësisht nga palët e interesuara. Një sërë rekomandimesh thelbësore të OSBE/ODIHR-it u morrën parasysh kur Kodi Zgjedhor u ndryshua gjerësisht në vitin 2012, si rezultat i një procesi gjithëpërfshirës reforme ligjore ku u përfshinë aktorët kryesorë politikë dhe shoqëria civile.
- Gjashtëdhjetë e gjashtë parti politike dhe dy kandidatë të propozuar nga zgjedhësit do të konkurrojnë në zgjedhje. Gjashtëdhjetë e dy parti do të konkurrojnë në zgjedhje si pjesë e njërit prej dy koalicioneve dhe katër parti do të konkurrojnë individualisht. Procesi i regjistrimit ishte gjithëpërfshirës. Tre partitë më të mëdha parlamentare u gjobitën, pasi nuk respekton kërkesat mbi kuotat e përkatësisë gjinore në listat e kandidatëve të tyre.
- Zgjedhjet do të administrohen nga një administratë zgjedhore me tre nivele, e cila përfshin KQZ-në, 89 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) dhe 5,508 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV-të). Numërimi do të zhvillohet në bazë të qarqeve në 89 Vende të Numërimit të Votave. Përbërja e komisioneve bazohet në emërime politike. Partitë politike vazhdojnë të zëvendësojnë anëtarët e KZAZ-ve pas përfundimit të trajnimit, duke ngritur shqetësime përse i përket paanëshmërisë dhe efektivitetit të tyre.
- Aktualisht, KQZ-ja funksionon vetëm me katër anëtarë, gjë e cila pengon aftësinë e saj në administrimin e zgjedhjeve në përputhje me ligjin. Deri tani, Kolegji Zgjedhor ka gjykuar 11 ankime kundër vendimeve të KQZ-së dhe mosmarrjes së vendimeve prej saj. Në një rast, ai mori përsipër përgjegjësinë e KQZ-së duke caktuar numrin e Zonave të Administrimit Zgjedhor.
- Ndërsa përgatitjet zgjedhore vazhdojnë, janë konstatuar vonesa, duke mosrespektuar disa afate ligjore. KQZ-ja zhvillon mbledhje publike, të shpeshta. Megjithatë, në disa raste, vendim-marrjes së saj i mungon transparenca. Disa vendime të KQZ-së janë kritikuar për mungesë të një arsyetimi të shëndoshë ligjor.
- Listat e zgjedhësve (LZ-të) janë përfunduar me një numër total prej 3,271,885 zgjedhësish me të drejtën për të votuar. LZ-të janë afishuar në shumicën e qendrave të votimit dhe

gjithashtu janë të disponueshme online. Sipas Ministrisë së Brendshme, janë ende në listë disa zgjedhës 348,346 pa adresë të plotë. Auditët e specializuar në lidhje me LZ-të, të emëruar nga dy partitë e mëdha politike raportojnë në KZQ dhe MB.

- Fushata në përgjithësi ka qenë e qetë dhe paqësore. Fushata e partive në koalicionin qeverisës ka theksuar arritjet në qeverisje, ndërsa partitë opozitare janë përqëndruar në çështjet e sigurimeve shoqërore, në luftën kundër korrupsionit dhe pretendimet për presion mbi dhe pushim nga puna të nëpunësve civilë. Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it ka vëzhguar disa aktivitete zyrtare të qeverisë të cilat janë përdorur për qëllime fushate.
- Kuadri ligjor për mbulimin e fushatës zgjedhore në media përfshin dispozitat për të gjithë transmetuesit në lidhje me minutazhin falas, pasqyrimin në lajme dhe reklamat me pagesë. Fushata mbulohet gjerësisht nga media, megjithëse informimi i zgjedhësve deri tani mungon. Reklamat politike të financuara nga institucionet publike janë transmetuar në televizione publike dhe private, megjithëse ndalohej me ligj. Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i OSBE/ODIHR-it monitoron 6 kanale televizive dhe katër gazeta të përditshme.

II. PARATHËNIE

Në përgjigje të ftesës së Misionit të Përhershëm të Republikës të Shqipërisë dërguar OSBE-së dhe bazuar në rekomandimet e Misionit të Vlerësimit të Nevojave zhvilluar nga data 11 deri më 14 Mars, Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR-it) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ-në) më datë 15 Maj. MVZ-ja drejtuar nga Conny McCormack, përbëhet nga ekipi kryesor me 15 anëtarë, me zyrë në Tiranë dhe nga 30 vëzhgues afatgjatë, të cilët u shpërndanë më datë 21 Maj në të gjithë vendin. Anëtarët e Misionit vijnë nga 24 Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. OSBE/ODIHR-i u ka kërkuar Shteteve pjesëmarrëse të dërgojnë gjer në 400 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet parlamentare të datës 23 qershor shihen gjërësisht si një test i rëndësishëm për aspiratat e Shqipërisë drejt aderimit në Bashkimin Evropian. Mjedisi politik, që nga zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2009, të parat zgjedhje të mbajtura në një sistem zgjedhor proporcional rajonal, ka qenë i tensionuar. Zgjedhjet reduktuan numrin e partive politike në parlament nga 12 në 6 dhe rezultuan në përfaqësim pothuaj të barabartë mes koalicionit qeverisës të kryesuar nga Partia Demokratike (PD-së) dhe opozitës të kryesuar nga Partia Socialiste (PS-së), respektivisht me 70 dhe 66 mandate.

Çështja e përbërjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka qenë në qendër të vëmendjes dhe interesit. Pas largimit të Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI-së) nga koalicioni qeverisës në prill 2013, parlamenti liroi nga detyra anëtarin e KQZ-së të propozuar nga LSI-ja i cili u zëvendësua nga një përfaqësues i Partisë Republikane (PR-së) nga koalicioni qeverisës¹. Ky shkarkim çoi në dorëheqjen e tre anëtarëve të propozuar nga opozita, të cilët ende nuk janë zëvendësuar.

Klima politike karakterizohet nga një polarizim i zgjatur dhe mosbesim mes PD-së dhe PS-së. Pjesa më e madhe e partive pjesëmarrëse iu bashkua njërit nga dy koalicionet për zgjedhjet e ardhshme:

¹ Neni 18 i Kodit Zgjedhor ofron një listë të gjërë argumentesh mbi mënyrën e përfundimit të mandatit të një anëtarit të KQZ-së, i cili nuk përfshin rikompozim të parlamentit apo informacion të ri mbi mospërmblidhjen e kritereve për anëtarësim.

25 parti janë në Aleancën për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim kryesuar nga PD-ja e Kryeministrit Sali Berisha, dhe 37 parti iu bashkuan Aleancës për Shqipërinë Evropiane të kryesuar nga PS-ja dhe udhëheqësi i saj Edi Rama. Të gjitha partitë parlamentare konkurrojnë me këto koalicione.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KUADRI LIGJOR

Të 140 deputetët e Kuvendit njëdhomësh (Parlamentit) zgjidhen për një periudhë 4-vjeçare në një sistem proporcional, me 12 zona zgjedhore (qarqe) shumë-emërore që i korrespondojnë qarqeve administrative të vendit. Partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit mund të konkurrojnë në zgjedhje. Listat e mbyllura të kandidatëve dorëzohen nga partitë për çdo qark. Partitë që marrin të paktën tre përqind dhe koalicionet që marrin të paktën pesë përqind të votave të vlefshme në një qark kualifikohen për ndarjen e mandateve.

Numri i mandateve për çdo qark shkon nga 4 në 32. Bazuar në statistikat e shpërndarjes së deritanishme të popullsisë paraqitur nga Ministria e Brendshme (MB), KQZ-së i kërkohet të llogarisë numrin e mandateve për qark dhe t'ia paraqesë atë parlamentit për miratim². Megjithëse është një përllogaritje teknike, KQZ-ja e ndarë politikisht dhe e paaftë të arrijë në një marrëveshje mbi numrin e mandateve për qarqe, e dërgoi çështjen në parlament. Më pas, parlamenti vendosi të caktojë shpërndarjen e mandateve në bazë të statistikave të popullsisë të vitit 2009 (në vend të atyre të vitit 2013)³.

Zgjedhjet parlamentare rregullohen nga një kuadër ligjor i plotë, duke përfshirë Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2008, i ndryshuar në korrik 2012. Ligje të tjera të zbatueshme përfshijnë: Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Tubimet dhe Kodin Penal. KQZ-ja dhe MB-ja plotësojnë kuadrin ligjor zgjedhor me udhëzime dhe vendime. KQZ-ja nuk miratoi të gjitha rregullat e nevojshme për përgatitjen e zgjedhjeve të pakten 60 ditë para ditës së zgjedhjeve, siç kërkohet nga neni 23.4 i Kodit Zgjedhor.

Pas një procesi të gjërë dhe gjithpërfshirës reformash ligjore, falë rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe Këshillit të Evropës, Komisionit për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Kodi Zgjedhor u ndryshua gjerësisht në korrik 2012, mbështetjen e partive politike kryesore. Këto ndryshime marrin parasysh një sërë rekomandimesh të mëparshme të OSBE/ODIHR-it mbi reformën ligjore duke përfshirë rishikime thelbësore të procesit të përzgjedhjes për komisionet zgjedhore, një proces të rishikuar për hartimin e listës së zgjedhësve, një proces të thjeshtëzuar për regjistrimin e kandidatëve, rregulla të paanëshme për aksesin në media dhe fondeve për fushatën publike, si dhe fuqizim të pavarësisë për Kolegjin Zgjedhor⁴. Kodi Penal i ndryshuar në mars 2012 përfshiu vepra penale zgjedhore të reja, fuqizoi dënimet për veprat penale ekzistuese dhe shfuqizoi afatet e burgimit për përgojim dhe shpifje.

Përgjithësisht, ndryshimet e 2012-ës përmirësuan ndjeshëm legjislacionin zgjedhor, i cili ofron një bazë të shëndoshë për zhvillim demokratik të zgjedhjeve. Sidoqoftë, nevoja për vullnet politik për të implementuar plotësisht dhe për t'ju përmbajtur legjislacionit është një parakusht për të arritur një proces zgjedhor vërtet demokratik dhe për të vendosur besimin në publik.

² Numri i madateve caktuar për cdo Qark duhet të bazohet mbi numrin e banorëve.

³ Dy mandate duhet të kishin ndryshuar qark sipas statistikave të deritanishme të popullsisë: qarku i Beratit dhe i Korçës duhet të kishin një mandat më pak dhe qarku i Durrësit dhe i Tiranës secili një mandat më tepër.

⁴ Kolegji Zgjedhor është organ gjyqësor i përbërë nga tetë anëtarë të zgjedhur nga gjyqëtarët e Gjykatës të Apelit përpara çdo zgjedhje për Kuvendin mandati i të cilëve është i limituar në gjykimin e ankimeve kundër KQZ-së.

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet administrohen nga një sistem administrimi me tre nivele, e përbërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)-ja, 89 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) dhe 5.508 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV-të). Votat do të numërohen në 89 Vende të Numërimit të Votave (VNV-të), një për secilën Zonë të Administrimit Zgjedhor (ZAZ-të).

KQZ-ja është organi i vetëm i përhershëm për administrimin e zgjedhjeve. Bazuar në ndryshimet e Kodit Zgjedhor të 2012-ës, kryetarin e miraton parlamenti nga emërimet që janë paraqitur nga partitë parlamentare pas një procesi të hapur aplikimi.⁵ Komisionet zgjedhore të të gjitha niveleve përbëhen nga shtatë anëtarë.

Gjysma e kryetarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve caktohen nga partia më e madhe e mazhorancës në parlament dhe gjysma tjetër nga partia më e madhe e opozitës. Gjashtë anëtarët e tjerë të komisionit caktohen në bazë të së njëjtës formulë në të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve: dy anëtarë propozohen nga partia më e madhe parlamentare dhe dy anëtarë nga opozita; partitë e tjera mazhoritare të parlamentit dhe partitë opozitare, secila propozon një anëtar. Jo më pak se 30 përqind e emërimeve të anëtarëve të KZAZ-ve duhet të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Partitë politike vazhdojnë të zëvendësojnë anëtarët e KZAZ-ve, pasi trajnimi ka përfunduar. Edhe pse ligji e lejon, kjo çështje krijon shqetësim në lidhje me paanëshmërinë dhe efektivitetin e tyre.

Megjithëse tre anëtarët e KQZ-së të emëruar nga opozita nuk kanë marrë pjesë në punën e KQZ-së që nga koha e dorëheqjes në mesin e prillit, KQZ-ja vazhdon të funksionojë me katër anëtarë. Ka lloje të veçanta vendimesh të Kodit Zgjedhor, që shprehimisht kërkojnë miratim nga një shumicë e cilësuar prej pesë votash, duke përfshirë certifikimin e rezultateve dhe ndarjen e mandateve. Së fundmi, KQZ-ja ka miratuar akte normative, të cilat kërkojnë pesë vota me shumicë të thjeshtë prej katër votash. Nga ana tjetër, KQZ-ja ka shmangur miratimin e vendimeve të nevojshme për të ndryshuar aktet e vjetëruara. Deri tani, KQZ-ja po vepron pa miratuar rregullat e saj procedurale, ashtu siç e kërkon ligji.

Disa vendime të KQZ-së janë kritikuar për mungesë të arsytimit të shëndoshë ligjor.

Përveç ndryshimeve të anëtarëve të KQZ-së, KQZ-ja zëvendësoi të gjithë anëtarët e KZAZ-ve të emëruar nga partia e dytë më e madhe e opozitës (Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut) me persona të përzgjedhur nga PR-ja “për shkak të rrethanave të reja që u krijuan në përbërjen e grupeve të mazhorancës parlamentare dhe opozitës”. Në një rast tjetër, KQZ-ja vendosi t’i rirëndisë në mënyrë manuale partitë në fletën e votimit, pasi ishte hedhur shorti për të përcaktuar renditjen e tyre, pavarësisht se ligji kërkon “një renditje të rastësishme, siç përcaktohet nga hedhja e shortit”.

MVZ-së së OSBE/ODIHR-it i është siguruar një bashkëpunim i plotë nga ana e KQZ-së. KQZ-ja zhvillon rregullisht mbledhje publike, të cilat transmetohen online. Megjithatë, mbledhjet, shpesh, thirren pa njoftim të rregullt. Vendimet e KQZ-së nuk publikohen menjëherë në faqen zyrtare të saj, ashtu sic parashikohet nga ligji. Kjo ul transparencën e procesit të vendimmarrjes në KQZ.

Ndërkohë që përgatitjet për zgjedhje janë duke vazhduar në të gjitha nivelet, disa afate ligjore nuk janë respektuar. Krijimi i KQV-ve u vonua përtej afatit ligjor të 24 majit, për shkak të paraqitjes me vonesë të emërimeve nga partitë politike. Për më tepër, dhe caktimi i disa vendndodhjeve të disa qendrave të votimit u vonua përtej afatit, për arsye të paraqitjes me vonesë ose me mangësi të propozimeve nga ana e Kryetarëve të Bashkive, si dhe gjithashtu për arsye të kundërshtimeve ligjore të vendndodhjes së tyre.

⁵ Kryetari i KQZ-së zgjidhet për një mandat 4-vjeçar, ndërsa 6 anëtarët e tjerë të KQZ-së zgjidhen për një mandat 6-vjeçar. KQZ-ja aktuale u miratua nga Parlamenti më 18 tetor 2012.

VI. TEKNOLOGJITË E REJA NË ZGJEDHJE

Kodi Zgjedhor i rishikuar (azhornuar) kërkon që KQZ-ja të testojë dy teknologji të reja zgjedhore për keto zgjedhje: Sistemin elektronik të verifikimit të zgjedhësit (SEV-në) në qarkun e Tiranës, dhe Sistemin elektronik të numërimit (SEN-në) në qarkun e Fierit. SEV-i është parashikuar të implementohet deri në 1,422 qendra votimi, duke mundësuar që të verifikohen dhe të regjistrohen automatikisht zgjedhësit në ditën e zgjedhjeve. Një test fillestar i funksionimit të pajisjeve të SEV-it u zhvillua më 17 Maj. Ndërkohë që KQZ-ja shprehu besim të përgjithshëm në funksionimin e SEV-it, përfaqësuesit e disa partive politike dhe shoqëria civile shprehën pakënaqësi në lidhje me paaftësinë e sistemit për të lexuar kartat e vjetëruara të identitetit apo për të ndaluar përpjekjet për votim më shumë se një herë në qendra të ndryshme votimi.

SEV-i përdor skanimin e fletës së votimit në VNV-të për të lehtësuar numërimin e fletëve të votimit. Në Prill, KQZ-ja zhvilloi një numër testesh, të cilat nxorrën në pah një numër problemesh të sistemit, ku përfshihej shpejtësia e ulët e procesimit dhe kapaciteti i pamjaftueshëm. Një vendim i KQZ-së i kohëve të fundit për të ruajtur modelin (dizajnin) e fletës së votimit, mund ta bëjë të pamundur përdorimin e projektit pilot SEN, meqenëse kapaciteti i sistemit të përzgjedhur kufizohet në 42 emra, ndërkohë që fleta përfundimtare e votimit liston 67. Përveç kësaj, një numër aktesh veçanërisht të nevojshme për implementimin e këtyre projekteve pilote kërkojnë një shumicë të cilësuar prej pesë votash në KQZ.

VII. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Shqipëria ka një sistem pasiv të regjistrimit të zgjedhësve. Listat e zgjedhësve (LZ-të) për zgjedhjet nxirren nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC-së), që mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në MB. Ndonëse zyrat e gjendjes civile të njësive të qeverisjes qendrore (NjQV) janë përgjegjëse për përmbajtjen e LZ-zë, KQZ-ja mbikëqyr procesin e përgjithshëm të hartimit të LZ-së. KQZ-ja gjobiti gjithsej 139 kryetarë të njësive të qeverisjes vendore për shkak mos dorëzimi apo dorëzim me vonesë të informacionit apo informacionit të paplotë mbi numrin e zgjedhësve dhe vendndodhjen e qendrave të votimit.

Qytetarët e moshës 18 vjeç ose më shumë gjatë ditës së zgjedhjeve kanë të drejtë vote, me përjashtim të atyre që janë shpallur të paaftë mendërisht me vendim gjykate. 1,130 qytetarë të moshës 100 vjeç ose më shumë u hoqën nga lista e zgjedhësve dhe 380 u rifutën me kërkesë të zgjedhësit. Sipas KQZ-së, numri përfundimtar i zgjedhësve është 3,271,885. MB-ja informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it që numri i rekordeve të dyshuara si të duplikuara ishte zvogëluar nga 7,674 në dhjetor 2012 në 1,139 në maj 2013, dhe se numri i përgjithshëm i zgjedhësve në LZ-të pa kod adrese të plotë ishte reduktuar nga 542,808 në shkurt në 348,346 zgjedhës në maj.⁶

Që nga janari, janë publikuar çdo muaj ekstrakte të përditësuara të përbërësve zgjedhorë nga baza e të dhënave të RKGjC-së. Subjektet zgjedhore mund të kërkojnë kopje të LZ-ve për qëllime verifikimi, gjë që u bë nga disa parti. KQZ-ja ka emëruar dy auditë teknikienë të propozuar nga PD-ja dhe PS-ja për të verifikuar cilësinë e LZ-së. Gjetjet dhe rekomandimet e tyre respektive iu paraqitën KQZ-së dhe u dërguan në MB për trajtim të mëtejshëm. Megjithatë auditë i PS-së vuri në dyshim saktësinë e të dhënave të siguruar dhe cilësinë e LZ-së, shumica e bashkëbiseduesëve të MVN-së së OSBE/ODIHR-it nuk i kanë shprehur këto shqetësime.

⁶ Zgjedhësit identifikohen nëpërmjet një numri 10-shifror (tre numrat e parë tregojnë bashkinë, katër të tjerët tregojnë qendrën e votimit dhe tre të fundit tregojnë kodin e adresës). Kur tre shifrat e fundit janë të panjohura, ato shënohen me 888, 999 ose 000.

LZ-të janë afishuar në shumicën e KQV-ve dhe KZAZ-ve të vizituara nga MVN-ja e OSBE/ODIHR-it deri më tani, megjithëse shpesh të afishuara pas afatit 20 maj. Zgjedhësit mund të kontrollojnë gjithashtu detajet e tyre në mënyrë elektronike. Zgjedhësit e hequr nga një LZ ose të regjistruar me gabime mund të paraqesin një kërkesë për korrigjim deri 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve në gjykatën e rrethit gjyqësor.

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Për të konkurruar për zgjedhjet, partitë politike dhe kandidatët e pavarur (të propozuar nga zgjedhësit) duhet të jenë të regjistruar si subjekte zgjedhore në KQZ. Fillimisht, KQZ-ja regjistroi 64 parti politike dhe 2 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit si subjekte zgjedhore, ndërsa gjashtë partive politike dhe pesë kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit iu refuzua regjistrimi. Këto gjashtë parti apeluan në Kolegjin Zgjedhor, i cili pranoi dy nga ankesat dhe urdhëroi KQZ-në të regjistrojë partitë e tyre dhe nuk pranoi katër ankimet e tjera.⁷ Gjithsej, KQZ-ja regjistroi gjashtëdhjetë e gjashtë parti dhe dy kandidatë të propozuar nga zgjedhësit.

Listat e kandidatëve të partive politike joparlamentare që konkurrojnë në mënyrë individuale, ose në koalicione që kanë më pak vende në parlamentin të cilit po i mbaron mandati, sesa numri i partive në koalicion, duhet të mbështeten nga firmat e përkatësisht 5,000 ose 7,000 zgjedhësve të regjistruar. Kandidatët e pavarur kanë nevojë për firmat e të paktën një përqind të zgjedhësve, (por jo më shumë se 3,000 zgjedhës) të regjistruar në zonën përkatëse. Një kandidat mund të konkurrojë vetëm në një zonë. Gjithashtu, personat që mbajnë pozicione publike të caktuara duhet të japin dorëheqjen për t'u bërë kandidatë.

Pasi i dha mundësinë partive për të bërë korrigjime, KQZ-ja miratoi të gjitha listat e kandidatëve, të cilat përfshijnë një total prej 7,127 kandidatësh, duke përfshirë 2,729 gra. Çdo listë kandidatësh duhet të ketë të paktën një mashkull dhe një femër në tre vendet e para dhe çdo listë duhet të përbëhet të paktën nga 30 përqind e secilës gjini. Për të përmbushur këtë kuotë, shumë parti përfshijnë gra në fund të listave, ku ato nuk kanë gjasa të fitojnë. Sipas ndryshimeve në 2012, gjoba për mosrespektim të kuotës së përkatësisë gjinore u rrit në 1 milion lek për listë.⁸ Megjithatë, dispozita që detyron KQZ-në për të refuzuar regjistrimin e çdo liste që nuk respekton kuotën e përkatësisë gjinore u shfuqizua. KQZ-ja vendosi gjoba ndaj tre partive parlamentare më të mëdha (PS-së, PD-së dhe LSI-së) se nuk respekton kuotën gjinore respektivisht në katër, gjashtë dhe katër zona zgjedhore. Ndonëse KQZ-ja i dha mundësinë këtyre partive për të korrigjuar listat, ata zgjodhën të mos e bënin këtë.⁹

IX. FUSHATA ZGJEDHORE DHE FINANCIMI I FUSHATËS

Periudha 30 ditore e fushatës nisi zyrtarisht më 24 maj dhe mbaron në mesnatën e datës 21 qershor kur fillon edhe periudha e heshtjes zgjedhore. Megjithatë, partitë e kanë filluar aktivisht fushatën përpara fillimit zyrtar të saj, kur figurat kryesore politike dhe zyrtarë të lartë qeveritarë kanë udhëtuar nëpër vend për të prezantuar kandidatët dhe programet në mitingje të shkallës së gjerë. Aktivitetet e fushatës janë kryer në mënyrë individuale nga partitë dhe jo nga koalicionet.

⁷ Në të dyja rastet e refuzara nga Kolegji Zgjedhor, KQZ-ja aplikoi kërkesa lidhur me dokumentacionin të cilat nuk përfshiheshin në kriteret ligjore për regjistrimin e partive. Në një rast, KQZ-ja refuzoi regjistrimin e një partie me arsyetimin se vërtetimi i gjykatës nuk përfshinte shkurtimin zyrtar, i cili nuk kërkohet me ligj.

⁸ I barabartë me rreth 7,120 EURO (1 EURO=140 LEK).

⁹ Më 24 maj, Kolegji Zgjedhor revokoi një gjobë prej tetë milionë lekësh ndaj Partisë Kristiandemokrate për shkeljen e kuotës së përkatësisë gjinore në tetë lista (ku mungonin të paktën 30 përqind burra), me arsyetimin që KQZ-ja nuk i kishte dhënë mundësinë për të korrigjuar listat.

Mjedisi i fushatës në përgjithësi ka qenë i qetë dhe paqësor. PD-ja thekson arritjet e qeverisë së saj dhe veçanërisht zhvillimin e infrastrukturës dhe rritjen e pagave të nëpunësve civilë. PS-ja kritikon qeverinë dhe premtën përparim të zhvillimit ekonomik (me anë të taksimit progresiv) dhe sigurimit shoqëror si dhe luftës kundër korrupsionit. Megjithatë, thelbi i mesazheve të fushatës shpesh mbetet në hije nga sulmet verbale midis dy partive të mëdha.

Partitë më të vogla shprehin pakënaqësi në lidhje me mungesën e mjeteve financiare dhe me aksesin e kufizuar në media dhe shprehin shqetësime në lidhje me parregullësi të mundshme në ditën e zgjedhjeve, veçanërisht gjatë numërimit. Këto parti tentojnë të bëjnë fushatë derë më derë ose të zhvillojnë mbledhje të vogla me zgjedhësit vetëm në zona ku presin një mbështetje më të madhe.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka vëzhguar disa aktivitete zyrtare qeveritare që janë përdorur për qëllime fushate. Përrurimi i rrugëve të reja dhe prezantimi i projekteve në lidhje me infrastrukturën, janë shoqëruar me slogane dhe flamuj të fushatës së PD-së. Faqja zyrtare e Kryeministrit mbulon aktivitetet e fushatës, që ai ndjek. Më 13 maj, Kryeministri nxori një urdhër sipas të cilit ndalohej përdorimi nga ana e zyrtarëve publikë i fondeve publike dhe mjeteve për qëllime fushate.

Partitë e opozitës pretendojnë se punonjësve të sektorit publik u kërkohet të marrin pjesë në tubime elektorale ose të sigurojnë mbështetje për partinë në pushtet. Për më tepër ato deklarojnë se mbështetësit e tyre, përfshirë persona që përfaqësuan opozitën në komisione zgjedhore gjatë zgjedhjeve të kaluara ose familjarët e tyre janë pushuar nga puna në sektorin publik për arsye politike. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it takoi disa nga këto ish-punonjës të cilët konfirmuan pretendime të tilla¹⁰.

Të gjitha partitë politike të takuara nga MVZ i OSBE/ODIHR deklaruan se ka patur vonesa në marrjen e fondeve publike për zgjedhjet. Parlamenti vendosi ndarjen e fondit publik vetëm më datë 30 maj, një javë pas fillimit të periudhës së fushatës zgjedhore¹¹. KQZ-ja miratoi ndarjen e fondeve midis subjekteve zgjedhore më datë 3 qershor¹². Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga fondi publik për fushatat e tyre zgjedhore.

X. MEDIA

Pavarësisht tregut të kufizuar të reklamave, në Shqipëri operojnë një numër i madh mediash. Televizioni dhe radio konsiderohen si burimet parësore të informacionit; media e shkruar ka një qarkullim të kufizuar, kryesisht në zonat urbane, ndërsa Interneti është falas. Mediat ofrojnë një shumëllojshmëri këndvështrimesh, por ato shihen si të politizuara.

Televizioni publik, *TVSH*, është i detyruar t'u ofrojë kohë falas partive politike bazuar në ç'ka ato përfaqësojnë në Parlament. Më 20 Maj, KQZ-ja vendosi t'i caktojë një minutazh total prej 60 minutash partive me më shumë se 20 përqind të vendeve në Parlament (PD-së dhe PS-së), 30 minuta për 4 partitë e tjera parlamentare, dhe 10 minuta për 60 partitë jo-parlamentare. Duke qenë se Kodi Zgjedhor nuk parashikon kohë transmetimi falas për kandidatët e pavarur, KQZ-ja vendosi t'u caktojë atyre nga 5 minuta secilit. Rradha e shfaqjes u caktua me anë të llotarisë. Që prej datës 24 Maj, *TVSH* ka transmetuar minutazhin falas çdo ditë që prej orës 18:30.

¹⁰ Ankimet u paraqitën në gjykatën e rrethit nga nënpunësit civilë të cilët deklarojnë largim të padrejtë nga puna për arsye politike. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it po ndjek ankimet.

¹¹ Parlamenti shpërndau 65 milionë lekë nga financimi publik i partive politike.

¹² Fondi publik i ndahet partive politike që e gëzojnë këtë të drejtë brenda pesë ditësh nga miratimi i listave të kandidatëve.

Kodi zgjedhor detyron të gjithë transmetuesit që të sigurohen që edicionet informative të përmbajnë kohë të barabartë për partitë që kanë më shumë se 20 përqind të vendeve në Parlament, e cila duhet të jetë dyfishi i sasisë së kohës së dhënë në krahasim me partitë e tjera parlamentare. Mbulimi në lajme i partive jo-parlamentare i lihet dëshirës së redaktorit. Aktivitetet e institucioneve publike që promovojnë arritjet institucionale, si p.sh. përrurimet e punimeve publike, konsiderohen si të lidhura me zgjedhjet dhe llogariten në minutazhin e partisë që lidhet me drejtuesin e institucionit. Propaganda dhe komentet politike nga gazetarët janë të ndaluara gjatë emisioneve të lajmëve. Materiali mbi fushatën, i regjistruar paraprakisht, i përgatitur nga partitë politike, duhet të jetë qartësisht i identifikueshëm si i tillë, me qëllim që të ruhet besueshmëria e lajmeve.

Reklamat politike të paguara, lejohen në televizionet private gjatë fushatës zyrtare. Megjithatë, kanalet televizive filluan të transmetonin spote publicitare politike më 23 Maj, përpara fillimit të fushatës zyrtare. Më 22 Maj, me anë të një deklarate për shtyp, KQZ-ja zgjati afatin e saj ligjor për dorëzimin e informacionit mbi tarifën e reklamës me tre ditë pas 23 Majit. Më në fund, KQZ-ja e publikoi listën e tarifave në faqen e saj të internetit.

Më 21 Maj, 37 ditë pas afatit, KQZ-ja krijoi Bordin e Monitorimit të Medias (BMM). BMM-ja ka për detyrë të monitorojë median dhe të propozojë sanksione administrative gjatë fushatës. KQZ-ja ka detyrimin ligjor të shqyrtojë raportet e BMM-së të paktën një herë në javë gjatë fushatës si dhe të marrë në konsideratë ankimet e dorëzuara nga subjektet zgjedhore. Sipas ligjit, secili nga anëtarët e KQZ-së emëron një anëtar për BMM-në nga lista e emrave të propozuar nga organizatat jo-përfutuese mbi median. Rreth dy javë pas afatit, KQZ-ja i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë t'i dorëzonte një 'listë' të këtyre organizatave. Pas kësaj KQZ-ja deklaroi publikisht se çdo organizatë jo-përfutuese mbi median mund të dërgonte propozime për anëtarësim në BMM-në, sepse lista e dërguar nga gjykata ishte e paplotë, meqenëse vetëm 14 nga 54 organizata morën njoftimin e KQZ-së¹³. Vetëm tetë organizata jo-përfutuese propozuan kandidatë.

Më 3 qershor, KQZ-ja miratoi procedurat që detyrojnë transmetuesit të njoftojnë BMM-në nëse refuzojnë të transmetojnë gjatë edicioneve të tyre informative material mbi fushatën, të regjistruar paraprakisht nga subjektet zgjedhore. Një numër bashkëbiseduesish të Misionit të Vëzhguesve Zgjedhorë të OSBE/ODHIR-it shprehën shqetësimin e tyre se procedurat e reja nënkuptonin detyrimin për transmetimin e një materiali të tillë, duke mos respektuar dispozitat e Kodit Zgjedhor.

XI. ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Ankimet kundër vendimeve të KZAZ-ve mund të paraqiten në KQZ dhe ankimet kundër vendimeve të KQZ-së në Kolegjin Zgjedhor, i cili ka një afat dhjetë ditor për të gjykuar.¹⁴ Në rastet kur, KQZ-ja nuk arrin të marrë një vendim brenda afatit ligjor, Kolegji Zgjedhor nuk mund të shqyrtojë çështjen në themel dhe duhet t'ja kthejë atë KQZ-së për të marrë një vendim brenda një afati dhjetë ditor. Kodi Zgjedhor nuk parashikon një proces dhe juridiksion të qartë për trajtimin e ankimeve në lidhje me fushatën.

Vetëm subjektet zgjedhore kanë të drejtë të ankohen kundër institucioneve të administratës zgjedhore. Aktorë të tjerë në procesin zgjedhor, të tillë si zgjedhës, grupe qytetarësh dhe OJQ-të, nuk mund të ankohen kundër vendimeve që kanë lidhje me zgjedhjet dhe kundër veprimeve që

¹³ Për shembull, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dhe Instituti Shqiptar i Medias nuk ishin përfshirë në këtë listë.

¹⁴ Ankimet kundër vendimit të KQZ-së në lidhje me tabelën përmbledhëse të rezultetit të qarkut gjykohen në shkallë të parë nga KQZ-ja.

ndikojnë mbi votimin e tyre ose të drejtat publike zgjedhore.¹⁵ Vendimet e Kolegjit Zgjedhor nuk mund të ankimohen në një gjykatë më të lartë. Gjykata Kushtetuese ka juridiksion të shqyrtojë vendime të gjykatave për të siguruar përputhshmërinë në lidhje me garancitë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, megjithëse nuk ka afate ligjore për dhënien e vendimeve gjatë periudhës së zgjedhjeve.¹⁶

Deri më sot, KQZ-ja nuk ka marrë ndonjë ankim kundër vendimeve të KZAZ-ve dhe Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it nuk është informuar në lidhje me ndonjë ankim të paraqitur pranë KZAZ-ve. Megjithëse, partitë kanë ngritur publikisht akuza për mosrespektim të fushatës, nuk janë përdorur mekanizmat formale të ankimit për të zgjidhur këto çështje. Kolegji Zgjedhor ka gjykuar 11 ankime kundër vendimeve të KQZ-së dhe mosmarrjes së vendimeve nga KQZ-ja. Një vendim i kontestuar lidhet me përcaktimin e numrit të ZAZ-ve nga Kolegji Zgjedhor, pas mosmarrjes së një vendimi nga KQZ-ja. Megjithëse, Gjykata ishte ligjërisht e detyruar të urdhëronte KQZ-në për të marrë një vendim, ajo gjykoi çështjen në themel dhe krijoi 89 ZAZ¹⁷.

Në 14 shkurt, PS-ja paraqiti një ankim në Gjykatën Kushtetuese duke kundërshtuar kushtetutshmërinë e një vendimi të parlamentit në lidhje me shpërndarjen e mandateve, duke argumentuar se parlamenti nuk ishte ligjërisht i mandatar të merrte një vendim pa një propozim të KQZ-së dhe se, mosaplikimi i statistikave të sotme, në lidhje me shpërndarjen e popullsisë nuk respektoi të drejtën e votës së barabartë. Në 7 mars, Gjykata Kushtetuese vendosi të refuzojë juridiksionin në lidhje me çështjen.¹⁸

XII. VËZHguesIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar. Subjektet zgjedhore kanë gjithashtu të drejtën për të caktuar vëzhgues. Vëzhguesit vendorë mund të emërohen nga organizatat joqeveritare vendase. Organizatat e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues në KZAZ-të, KQV-të dhe në çdo tavolinë të numërimit të votave të VNV-ve. Si rregull, KQZ-ja akrediton vëzhguesit.¹⁹ Partitë politike dhe kandidatët e pavarur mund të caktojnë nga një vëzhgues për qendër votimi dhe nga një për tavolinën e numërimit të votave. Koalicionet mund të caktojnë tre vëzhgues për qendër votimi dhe tavolinë të numërimit të votave. Një parti që është anëtare e një koalicioni nuk ka të drejtë të caktojë vëzhgues në mënyrë të pavarur. Deri tani, KQZ-ja ka akredituar 299 vëzhgues vendorë nga 3 organizata dhe 631 vëzhgues ndërkombëtarë.

XIII. AKTIVITETET E MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it filloi aktivitetin e tij në Tiranë me një konferencë për shtyp më 15 Maj. Shefja e Misionit është takuar me Kyeministrin, me anëtarët e KQZ-së, me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Krytaren e Parlamentit, Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, me anëtarët e Kolegjit Zgjedhor, dhe me përfaqësues të partive politike, medias dhe shoqërisë civile.

¹⁵ Zgjedhësit mund të ankohen vetëm në rast të përjashtimit nga regjistri i zgjedhësve dhe shoqëria civile mund të ankohet vetëm kundër vendimeve që u mohojnë të drejtën për t'u akredituar si vëzhgues të zgjedhjeve.

¹⁶ Në një takim me Misionin e Vëzhguesëve të OSBE/ODIHR-it, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese konstatoi se, megjithë juridiksionin sipas nenit 131.f të Kushtetutës, çdo ankim në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me mosrespektimin e një procesi të rregullt ligjor nga Kolegji Zgjedhor automatikisht nuk do të shqyrtohet nga gjykata.

¹⁷ Propozimi administrativ i diskutuar fillimisht nga KQZ-ja përfshinte 76 ZAZ, megjithëatë u ndryshua në 89 ZAZ kur u paraqit në gjykatë. PS-ja pretendon se numri 89 iu propozua nga PD-ja gjatë negociimeve private.

¹⁸ Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk kishte ezauruar mjetet ligjore sic kërkohet nga neni 131.f të Kushtetutës. Megjithëse vendimet e parlamentit nuk mund të rishikohen nga Kolegji Zgjedhor ose nga ndonjë gjykatë tjetër.

¹⁹ Neni 6.6 i Kodit Zgjedhor parashikon që KQZ-ja, 'me udhëzimin e saj', mund t'u delegojë të drejtën për të akredituar vëzhgues të subjekteve zgjedhore KZAZ-ve. Deri tani, KZAZ-të nuk kanë akredituar asnjë vëzhgues.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka vendosur kontakte të rregullta me administratën zgjedhore në të gjitha nivelet, institucionet qeveritare të përfshira në procesin zgjedhor, shoqërinë civile dhe median.

Për vëzhgimin në ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it do të bashkojë përpjekjet me delegacionet nga Asambleja Parlamentare (AP) e OSBE-së dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës (APKE). Roberto Batelli është emëruar si Koordinator Special, nga Shefi i Zyrës së OSBE-së për të drejtuar misionin e vëzhguesve afatshkurtër për këto zgjedhje.

*Përkthim jo zyrtar.
Versioni anglisht është i vetmi dokument zyrtar.*